



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2022:188090

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05431758

**P.nr.409/22**

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. K. nga fsh. L. i P. K. P., i akuzuar nga Prokuroria Themelore ne Prishtine me aktakuzën saj PP.II.nr.1725/22 të dt.09.09.2022, për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafin 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datën 26.02.2024, në prani të prokurores së shtetit Hava Krasniqi dhe të pandehurit, në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit:

**M. K.** i lindur me datë ... në fshatin L. i P. K. P. ku edhe jeton, nga babai A. dhe nëna S., e gjinisë M., i martuar, ka të kryer shkollën e lartë, kamarier, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i pa dënuar, mbrohet në liri.

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me datë 01.02.2022, rreth orës 17:45 në Lipjan, konkretisht në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinë “Adem Jashari”, gjatë kontrollës së dokumenteve në shkuarje, i pandehuri ka përdorur vizën e Polonisë me numër ... të vendosur në faqen e 17-të në Pasaportën e Republikës së Kosovës me numër ... për të udhëtuar në drejtim të Austrisë, në atë mënyrë që i pandehuri me dashje ka përdorur këtë dokument të falsifikuar me qëllim të shfrytëzimit të këtij dokumenti si origjinal ku identifikimi i të pandehurit është bërë nga Policia me pasaportën e Kosovës, ashtu që në bazë të raportit të ekspertizës të pranuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë, me nr. ... vërtetohet se dokumenti i evidentuar ne dëshminë #1 viza me numër ... e vendosur në faqen me numër rendor 17-të pasaportës ka kualitet të mirë dhe i posedon tiparet mbrojtëse të sigurisë sipas teknologjisë standarde të prodhimit, mirëpo viza në të ka ndërhyrje-fshirje mekanike në pjesët: në datën (muajin) e skadimit, tek numri i ditëve të qëndrimit “..”, tek fjala “..” si dhe në kodin IC..AO, si dhe ka të dëmtuar prapavijën, e që rezulton se është falsifikim i pjesshëm,

-me këtë ka kryer veprën penale Falsifikim i dokumenteve nga neni 390 paragrafin 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69 dhe neni 390 paragrafin 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

## DËNIM ME GJOBË

Me dënim me gjobë në shumë prej 300 € (treqindeuro), të cilin dënim i pandehuri detyrohet ta paguaj në afat prej 15 dite, nga dita e plotëfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë, konform nenit 43 par.3 të KPRK-së, do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku për një ditë burgu do ti llogaritet shuma prej 20.-€ dhe

Me dënim me burgim prej 3 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti nuk kryen vepër tjetër penale në të kundërtën dënimi me kusht do te revokohet.

**DETYROHET** i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale kësaj gjykate t'ia paguajnë paushallit gjyqësor shumë prej 20-€, si dhe shumë nga 20-€, në Fondin për Kompensimin e Viktimave, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

**URDHËROHET** konfiskimi i përhershëm i dokumentit të falsifikuar Pasaportës së Republikës së Kosovës ... i cili dokument përmban Vizën e shtetit të Polonisë me nr...., i vendosur në faqen 17 dhe urdhërohet asgjësimi apo shkatërrimi i dokumentit të falsifikuar.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.1725/22 të dt.09.09.2022, e ka akuzuar të pandehurin M. K. nga fsh. L. i P. K.P., për shkak të veprës penale Falsifikimi i dokumenteve nga neni 390 paragrafin 2 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar prokurorja e shteti ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajsisë nga ana e të pandehurit i njëjti është në pajtim me provat të cilat gjinden në shkrasat e lëndës mbi të cilat është ngritur aktakuza, duke i propozuar gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit si dhe me rastin e matjes së dënimit ti merr parasysht rrethanat e parapara me ligj.

Në shqyrtimin fillestar i pandehuri M. K. ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se i vie keq për këtë që ka bërë dhe nuk e ka ditur se viza është e falsifikuar, është hera e parë që ka ra ndesh me ligjin dhe ndihet shumë i penduar sepse është njeri i arsimuar, është mbajtës i familjes dhe i ka kërkuar gjykatës që ti shqipton një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkellje të qarta ligjore e as gabime faktike, konform nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet.

Matja dhe caktimi i dënitimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes se veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është i moshës relativisht të re që lenë për të kuptuar se mund të bëhet në të ardhmen antar i dobishëm i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjti i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës.

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku në emër të paushallit gjyqësor ju caktua shuma prej 20-€ duke marr parasysh ndërlikshmërinë e rastit dhe faktin këtu se i pandehuri qysh në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajsinë ndërsa shuma prej 20-€, u bazua në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimet.

Konfiskimi i sendeve.

Vendimi për konfiskimin e dokumentit të falsifikuar pasaportës së Republikës së Kosovës u bazua në nenin 276 par.1 dhe 2 nën par.6 lidhur me nenin 277 të KPPK-së.

Nga arsytet e cekura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**  
**P.nr.409/22 dt.26.02.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Gentiana Dakaj**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 ditë nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.